# KOMUNA RAHOVEC

2020

NËNTOR

# BULETINI MUJOR KOMUNAL



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1604 Nr. i faq/Br.str/No.pg 161
Data/Datum/Date 17/12/2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

## PËRMBAJTJA

HYRJE ........................................................................................................................ 3
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE ........................................................ 4
PËRFUNDIM ................................................................................................................ 13

# HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin nëntor, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

# AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari Smajl Latifi së bashku me drejtorin e Inspektoratit Besnik Hoti, kanë zhvilluar një takim koordinues me inspektorët e komunës së Rahovecit. Krahas prioriteteve, siç janë: Eliminimi i konkurrencës së padrejtë tregtare, mbrojtja e hapësirave publike, krijimi i një mjedisi të pastër, parandalimi i ndërtimeve ilegale etj... Kryetari Latifi ka kërkuar rritje të intensitetit të punës dhe inspektimeve nga ana e inspektorëve komunal, si dhe shqiptim të gjobave mandatore për të gjithë ata që nuk veprojnë sipas ligjeve në fuqi.

Është mbajtur takimi i Shtabit të Posaçëm Emergjent të Komunës së Rahovecit, ku për shkak të pandemisë po përballemi me një situatë mjaft të vështirë, megjithëse nuk po mungon angazhimi institucional në parandalimin e COVID 19. Kryetari Latifi ka kërkuar nga qytetarët të vazhdojnë t'i respektojnë masat parandaluese dhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë, sepse beteja me armikun e padukshëm Covid-19 po bëhet çdo ditë e më e vështirë.





Në Fortesë nis realizimi i projektit për rregullimin dhe ristrukturimin e shtratit të lumit "Rimnik".
Kryetari Smajl Latifi së bashku me drejtorin e DUPMM-së, menaxherin e kontratës Rumir Zhuniqin dhe bashkëqytetarë, ishin të pranishëm në fillimin e punimeve për rregullimin dhe ristrukturimin e shtratit të lumit, Rimnik. Me këtë investim komuna e Rahovecit synon të zgjidhë problemet e shumta që kanë shkaktuar vërshimet në dëm të banorëve dhe bujqëve.
Urime qytetarëve të Fortesës, e gëzofshi!



**Kryetari Smajl Latifi bashkë me kryetarin e këshillit të fshatit Krushë e Madhe, z.Selami Hoti, bashkëpunëtorë e bashkëqytetarë pritën për vizitë Kryetaren e Këshillit Kombëtar të Zvicrës, znj. Isabelle Moret, e përcjellur nga anëtarë të këshillit, Ambasadorin fuqiplotë të Zvicrës në Kosovë z. Thomas Kelly, zv/Ambasadoren, znj. Pauline Menthonnex si dhe zyrtarë të tjerë. Vizitën e filluan me homazhe dhe nderime në Komplekin Memorial në Krushë të Madhe, në nderim të 241 të rënëve për liri, 64 prej të cilëve janë ende të zhdukur. Për vizitë qëndruan edhe në KB "KRUSHA", ku u mirëpritën nga znj.Fahrije Hoti dhe gra të cilat janë ngritur mbi tragjedinë që u ka shkaktuar lufta, duke u fuqizuar si vlerë e shtuar e ekonomisë së vendit.**

Kryetari Smajl Latifi bashkë me nënkryetarin, z.Fatmir Iska, drejtorin e DMSH-së, z.Hasan Përboqi, drejtorin e DSHP-së, z. Përparim Krasniqi dhe qytetarë të shumtë të Lagjes së Epërme të Rahovecit, kanë bërë përurimin e projektit të rrjetit të ndriçimit publik. Qytetarëve të Rahovecit, në kuadër infrastrukturës i është shtuar tashmë edhe ndriçimi, që rrit edhe sigurinë e tyre. Investimi në ndriçim publik përfshin këto rrugë: Rr. "Bekim Isma" -30 trupa ndriçues modern (në shtylla metalike), si dhe 50 trupa të tjerë ndriçues në shtyllat ekzistuese të rrymës elektrike në rrugët: "Dëshmorët e Demokracisë", "Ëilliam Ëalker", "Metush Canziba" dhe "Valbona".



Komuna e Rahovecit ka pranuar donacion 4 kamionë për grumbullimin e mbeturinave, që do të ndihmojnë në rritjen e aftësisë së komunës sonë, për të mbledhur mbeturinat në mënyrë më efektive, pra jo vetëm në ruajtjen e pastërtisë së qytetit, por edhe në përmirësimin e mjedisit dhe cilësisë së jetesës së qytetarëve tanë.





Në vigjilje të 28 Nëntorit të Lavdishëm, Kryetari Smajl Latifi me bashkëluftëtarë, miq dhe familjarë kanë bërë zbulimin e pllakave përkujtimore në Rahovec, si: në shtëpinë e dëshmorit të kombit Sadedin Bajram Hajdës, vëlla i heroit të spikatur të luftës për liri, Xhelal Hajda-Toni, në shtëpinë e Halil Mullabazit, vëlla i heroit të kombit Selajdin Mullabazi -Mici si dhe në Celinë në shtëpinë e bashluftëtarit të Sali Fazliu, e cila ka shërbyer si bazë e UÇK-së.



Zbulimi i pllakave përkujtimore u bë edhe në këto fshatra:

*Në Senoc shtëpia (Halim Hamëz Krasniqi), e cila dikur shërbente si ambulantë e UÇK-së, Polluzhë shtëpia e (Ibrahim Morinës) -që ka qenë bazë logjistike e UÇK-së, Polluzhë- shtëpia e dëshmorit të Kombit (Shani Hotit) që shërbente si ambulantë e UÇK-së, Çifllak- shtëpia e (Agim Thaçit)- bazë iluftës së UÇK-së, Çifllak - shtëpia e (Jahë Sali Kabashit)-Mulliri që ka qenë bazë logjistike e UÇK-së, Ratkoc- shtëpia e (Qamil Adem Krasniqit)- bazë ilegale e LKÇK-së dhe bazë e UÇK-së dhe në Ratkoc - shtëpia e (Malush Rasim Latifit)- dikur bazë ilegale e LKÇK-së dhe bazë e UÇK-së.



Përurohet projekti: "Investim në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave për fëmijë" në lagjjen Patok të Rahovecit

Kryetari Smajl Latifi bashkë me drejtoreshën e DKRS-së, nënkryetarin bashkëpunëtorë e qytetarë të pranishëm të lagjes e fatosa të vegjël, kanë përuruar projektin e shumënevojshëm të ndërtimit të një fushe të vogël sportive, këndit të lojërave për fëmijë dhe hapësirën për lojëra në shah etj, në lagjjen Patok të Rahovecit.




Rahoveci me objekt bashkëkohor të Mjekësisë Familjare

Edhe një kulm shërbimi shëndetësor po i shtohet zinxhirit të objekteve shëndetësore në Rahovec. Është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, që u përurua, hapësirat moderne të së cilës, kushtet e përshtatshme për punë, shërbimet shëndetësore të mjekësisë familjare, rentgenit, laboratorit dhe emergjencës të cilat, do t'ju ofrohen mbi 56 mijë qytetarëve të komunës së Rahovecit. Ky projekt i ka kushtuar komunës së Rahovecit rreth 918 mijë euro. Objekti është 2200 m2, ka 20 shtretër dhe 4 dhoma të intervenimit.

Me rastin e 28 NËNTORIT, Kryetari Smajl Latifi së bashku me bashkëpunëtorë, veteranë të UÇK-së dhe me qytetarë, filluan ditën me homazhe nëpër vendrëniet dhe komplekset përkujtimore në Rahovec, kujtuan sakrificën e shumë brezave dhe nderuan kujtimin e veprës së të rënëve në kohë e përpjekje për liri, pavarësi e dinjitet kombëtar



Në festën e 28 Nëntorit- Ditën e Flamurit në Krushë të Madhe nis ndërtimi i Muzeut

Për të pasur ende në kujtesën e gjeneratave të reja, atë që ka ndodhur para 20 vjetësh, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, veterantë të UÇK-së, dhe bashkëqytetarë kanë vënë gurthemelin për ndërtimin e projektit: "Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe".Projekti do të realizohet në bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.





Drejtori Berat Duraku bashkë me drejtorin e Kadastrit dhe Gjeodezisë z. Afrim Oruqi kanë përcjellur punimet e projektit për "Ndërtimin e stallave për fermerë" që është bashkëfinancim i komunës së Rahovecit dhe fermerëve.

Në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë, komuna e Rahovecit është duke ndërtuar 15 stalla për fermerët e komunës sonë.



Në fshatin Zatriq, kanë filluar punimet për rregullimin e parkut rekreativ. Kryetari i komunës z. Smajl Latifi, së bashku me nënkryetarin z. Fatmir Iska, drejtoreshën e DKRS-së znj. Bjondina Kleqka dhe drejtorin e DEZHT-së z. Artan Asllanin, vizituan hapësirën në të cilën do të zhvillohen punimetl.



Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vazhdon me përkrahje në promovimin e sportit në komunën tonë.

Kësaj radhe, përkrahet çiklisti Ferat Durguti, përmes përkrahjes për promovim të sportit të çiklizmit, me qëllim të inkurajimit dhe krijimit të kulturës së çiklizmit në vend.



Fëmijët e Zaqishtit iu gëzuan parkut të ri të fshatit. Së shpejti do të përfundojnë punimet dhe parku do të jetë me infrastrukturë të kompletuar.



Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi për mbështetjen financiare të projektit "Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe". Projekti "Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe", parasheh mbledhjen, dokumentimin dhe vënien në dispozicion për publikun të rreth 300 intervistave të të mbijetuarve që kanë qenë dëshmitarë dhe kanë përjetuar masakrën e Krushës së Madhe të Rahovecit.



Vazhdojnë punimet në kuadër të projektit "Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë", projekt ky shumë i nevojshëm për zhvillim të aktiviteteve kulturore në këtë vend.

Në kuadër të këtij projekti do të rregullohet, amfiteatri dhe infrastruktura përcjellëse, për organizimin e festivali tradicional kombëtar të folklorit "Anadrinia Jehon".




Për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Klubin e Shahut "Rahoveci" dhe Këshillin Rinor "Rahoveci", organizuan turnirin regjional ne shah, i cili është mbajtur për herë të parë në nivel regjional në Komunën e Rahovecit.



Projekti i rrjetit të ujërave fekale në fshatin Nashpall, i nisur para pak kohe, tashmë projekt i përfunduar.



Mirëmbajtja e mjedisit prioritet i qeverisë komunale

Komuna e Rahovecit ka organizuar një aktivitet mjedisor, në bashkëpunim me kompaninë EAE Njaz nga Rahoveci, i cili vullnetarisht u angazhua në eliminimin e deponisë inerte në rrugën "Bekim Isma" në Rahovec!



Vazhdojnë punimet në trajtimin e ujërave atmosferik në qytetin e Rahovecit.



Drejtori i DSHP me kolegët nga Inspektorati dhe ai i Financave mbajtën takim me operatorë të kompanive publike.



Edhe një projekt i ri për siguri në trafik në qytetin e Rahovecit. Ka filluar projekti i rregullimit të semaforëve të rinjë në qytet.

1.Kryqëzimi i parë në vendin ku kanë qenë semaforët e vjetër,
2.Kryqëzimi i dytë, në rrugën "Gëzim Hamza",
3.Kryqëzimi i tretë, "Avdullah Bugari" dhe "Ali Sokoli".



Është kompletuar infrastruktura publike në rrugën "Jahja Danuza"!

- Rrjeti i kanalizimit,
- Rrjeti i ujësjellësit,
- Rrjeti i rrymës elektrike.



Disa intervenime emergjente në qytetin e Rahovecit!
Pamje nga rehabilitimi i ujëmbledhsave në rrugë.



Vazhdon rregullimi i pusetave të dëmtuara në disa pjesë të qytetit në Rahovec!



Ka filluar meremtimi i rrugës Celinë-Fortesë, nga kompania e kontraktuar.

Ky projekt ka për qëllim mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore!

Vazhdojmë...!



Përfundoj edhe një segment i rrjetit të ujërave fekale në fshatin Fortesë në lagjen Jupa!



Me aktivitet vullnetar nga kompania Ekodrinia, është bërë eliminim i një deponie ilegale nga mbeturinat e përziera në rrugën Polluzhë-Pastasel!



Është pëfunduar një punë emergjente në fshatin Brestoc!

Ndërtimi i murit mbrojtës në një rrugë ka qenë nevoje emergjente për shkak të sigurisë dhe ndalimit të shembjes së dheut!



Parku në qendër të fshatit Ratkoc.

# PËRFUNDIM

**Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:**
**(nëntor 2020).**
**Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t`iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.**
**Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.**
**Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.**

Rahovec, dhjetor 2020